

Politikani i Ri

Fletore e Akademisë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike

Politikani i Ri

Fletore e Akademisë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



**NATIONAL
DEMOCRATIC
INSTITUTE**
FOR INTERNATIONAL AFFAIRS

Lejohet prezantimi, kopjimi dhe shpërndarja e librit në tërësi apo në pjesë, me kusht që: (a) materialet të përdoren duke i njohur USAID-it dhe NDI-së autorësinë e botimit, (b) ky libër do të shërbejë vetëm për përdorim informativ, jo-tregtar dhe personal, (c) të mos bëhen modifikime të këtij libri.

Ky libër u mundësua përmes mbështetjes së ofruar nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nën Marrëveshjen Bashkëpunuese (Cooperative Agreement) Nr. 182-A-00-04-00104-00 me NDI. Opinionet e shprehura në këtë botim janë të vetë autorëve dhe si të tilla nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID.

Botuar nga Shtëpia Botuese “PEGI”

Rruga e Elbasanit, Pallatet Fratari, Filipeu Nr.2, Tiranë

Tel: +04 374947

Fax: +04 374947

Përgatitur nga Dan Redford, Najada Tafili, Elton Stefani, Blerina Karagjozi

Faqosja: Erald Velmishi

ISBN: 99943-705-5-3



Përmbajtja

• Parathënie	VI
• Dy fjalë për kontribuesit	VIII
1. Roli i mediave në zgjedhje <i>Astrit Kola</i>	1
2. Media, faktor i rëndësishëm në zgjedhje <i>Bashkim Tola</i>	4
3. Zgjedhjet dhe media <i>Dr. Zhuljeta Demi</i>	9
4. Gratë në politikë <i>Erisa Arizi</i>	13
5. Të kuptosh politikat e zhvillimit për t'u integruar në BE <i>Migena Reçi</i>	15
6. Procesi i Stabilizim – Asociimit <i>Mariel Mejdî</i>	17
7. Roli i qytetarëve në procesin zgjedhor <i>Flutura Hasa</i>	19
8. Standartet për minoritetet, kyç për të arritur Evropën <i>Kostantina Bezhani</i>	21
9. Dhënia e informacionit gjatë zgjedhjeve <i>Ziza Isufi</i>	24
10. Pse kaq e vështirë?! <i>Suela Kokoshi</i>	28
11. Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA)	30

Parathënie

National Democratic Institute for International Affairs, me anë të programit të tij ka kënaqësinë t'ju paraqesë një sërë shkrimesh në vijim të numrave të mëparshëm të fletores “Politikani i Ri”. Autorët e tyre janë pjesëmarrësit e përfshirë në programin e Akademisë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike, të cilët japin ndihmesën e tyre në realizimin e misionit të programit.

Në këtë numër do të keni mundësi të lexoni mendime dhe ide të ndryshme në lidhje me rolin e medias në zgjedhje, duke pasur parasysh që në sistemin demokratik media konsiderohet si pushteti i katërt, ajo ka një rol vendimtar në procesin zgjedhor; rolin e gruas në politikë, do të keni mundësi të kuptoni se si gruaja përballet jo vetëm me vështirësitë në familje por edhe me pengesat për të marrë pjesë aktive në jetën politike.

Gjithashtu mund të gjeni mendime në lidhje me standardet për minoritetet, si një domosdoshmëri në plotësimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; politikat e zhvillimit të vendit, si nevojë për të ndihmuar në procesin e integritimit në BE; roli i qytetarëve në procesin zgjedhor, si pjesa më e rëndësishme në mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve.

Opinionet e shprehura në këtë publikim janë të vetë autorëve dhe nuk përfaqësojnë këndvështrimet e NDI.

Në këtë botim ne shpresojmë që të kemi mundësuar paraqitjen e një fryme të re në vazhden e botimeve në fushën e politikës.

Dan Redford
Këshilltar i Lartë për Partitë Politike dhe Proceset Zgjedhore
Elton Stefani
Oficer Programi/Akademia për Udhëheqësi dhe Reformë Politike
Najada Tafili
Oficere Programi/Akademia për Udhëheqësi dhe Reformë Politike
Blerina Karagjozi
Asistente Programi/Akademia për Udhëheqësi dhe Reformë Politike

NDI/Shqipëri
Qershor 2005
Tiranë

Dy fjalë për kontribuesit



Astrit Kola

Zëdhënës Politik,
Partia Lëvizja e Legalitetit

Bashkim Tola

Kryetar i Nëndegës Gjirokastër,
Partia Socialdemokrate



Dr. Zhuljeta Demi

Përfaqësuese e Gruas,
Partia Demokratike

Erisa Arizi

Anëtare, Partia Socialiste e Shqipërisë





Migena Reçi

Anëtare e Forumit Rinor,
Partia Demokratike

Mariel Mejdi

Kryetar i Grupit Universitar Demokrat,
Partia Demokratike



Flutura Hasa

Anëtare e Kryesisë së Forumit të Gruas,
Partia Demokratike e Re



Kostantina Bezhani

Kryetare e Forumit të Gruas, PBDNJ



Ziza Isufi

Anëtare e Kryesisë së Gruas,
Partia Demokratike



Suela Kokoshi

Anëtare, Partia Republikane e Shqipërisë



1. Roli i mediave në zgjedhje

Astrit Kola

Meqenëse zgjedhjet kundrohen si aksioni politik më gjithëpërfshirës për promovimin e demokracisë dhe qeverisjes në nivele qendrore e vendore dhe njëkohësisht edhe si pjesë e reagimit publik ndaj funksionimit dhe rotacioneve demokratike të pushtetit, roli i mediave në raport me to është tejet i madh dhe i pazëvendësueshëm. Tek mediat, politika ka patur dhe do të ketë përjetësisht hallkën ndërmjetëse që e lidh me opinionin publik dhe votuesit, si dhe përcjellësin e mesazheve për njohjen e alternativave programore, këndvështrimeve për qeverisjen, shoqërinë dhe vendim-marrjen që lidhet me to. Nëse mendimi dhe aksioni politik, për mediat është ushqim i përditshëm dhe lëndë e parë, politika nga ana e saj nuk mund të shkrihet dhe të depërtojë me efikasitet përveçse nëpërmjet mediave, tek ata që e votëbesojnë atë, pra tek qytetarët-zgjedhës. Zgjedhjet kërkojnë intensitet maksimal të kontakteve midis zgjedhësve, kandidatëve dhe subjekteve respektive. Funkzioni dhe misioni i mediave në sigurimin e komunikimit midis tyre, realizon edhe njohjen reciproke midis kategorive që përbëjnë komponentët më të përgjegjshëm dhe institucionalë të një demokracie funksionale dhe eficiente. Mediat, si institucionet më përfaqësuese dhe autentike të opinionit publik, njëkohësisht janë edhe ngrehinat institucionale, në themel të suksesit të të cilave qëndron besueshmëria e publikut të gjerë ndaj institucioneve të shoqërisë demokratike. Mediat kanë një rol vendimtar në zhvillimin dhe kurorëzimin me sukses të fushatave zgjedhore. Ato mund të ndikojnë fuqimisht në ç'tensionimin e tyre,

në ekuilibrimin dhe uljen e agresivitetit të subjekteve e kandidatëve konkurrues. Pikërisht për këtë arsye, në Kodin Zgjedhor është parashikuar edhe rregullimi ligjor dhe kontributi i kontrolluar dhe i monitoruar i tyre, në funksion të prezantimit publik të një fushate të moderuar, konform standardeve demokratike të gjithëpranuara dhe të së Drejtës së Informimit Publik të zgjedhësve dhe qytetarëve në përgjithësi. Krijimi i raporteve të besueshmërisë dhe paanshmërisë së mediave, para dhe gjatë fushatave zgjedhore, si dhe shmangia e ndikimeve dhe kontrollit politik për përfitime parciale, janë parakushte për pjesëmarrje dinjitoze të mediave në aktet madhore për fatet e demokracisë, sikundër janë zgjedhjet. Pavarësisht raporteve strukturore të minutazhit të emetimit të aktiviteteve politike në favor të partive të mëdha, mediat vizive disponojnë hapësira të pakufishme për balancimin e kohës dhe transmetimin profesional të alternativave politike të subjekteve konkurrues, të konsideruar “minorë”. Mënyra më e mirë për realizimin e skemave efikase, jashtë ndikimeve dhe synimeve diferencuese, është programimi dhe realizimi i debateve publike, ku mund të vendoseshin përballë përfaqësues të njohur të alternativave konkurruese, duke u dhënë përparësi subjekteve të “diferencuara me ligj”. Pavarësisht minutazhit, mediat vizive duhet të ndjekin aktivitetet publike gjatë fushatave dhe në kronikat e tyre duhet të pasqyrojnë në mënyrë të sintetizuar mesazhet politike, duke anashkaluar përshkrimet narrative të panevojshme dhe joprofesionalë. Gjithashtu, mediat vizive, në funksion të pasqyrimin me ndershmëri të fushatës dhe kontribuimit balancues të tyre, lipset të ulin ndjeshëm tarifat e transmetimit të spoteve televizive dhe t’i programojnë ato në pikun e shikueshmërisë.

Ndërsa mediat e shkruara në raport me ato vizive, kanë mundësi shumë të mëdha për përcjelljen tek lexuesit të thelbit të alternativave dhe artikullimit politik të përfaqësuesve më të shquar të tyre, duke iu shmangur klientelizmit dhe preferencave të editorëve. Për realizimin me objektivitet dhe paanshmëri të këtij qëllimi, një rol të rëndësishëm mund të luajnë OJQ-të dhe organizmat monitorues të akredituar si rezidentë në vend, apo të atashuar posaçërisht gjatë fushatave. Nëse e Drejta e Informimit të shtetasve është një e Drejtë Themelore në demokraci, privimi selektiv i shtetasve për shkak të bindjeve politike, është një shkelje flagrante e kësaj të Drejte. Gjithsesi, sa kohë që në mediat

e shkruara janë formësuar lobingje dhe aleanca politike në favor të partive të mëdha, pasqyrimi i alternativave dhe kandidatëve të subjekteve rivale ndaj tyre, mbetet një handikap me pasoja të padëshirueshme në realizimin e fushatave të ndershme, zgjedhjeve të lira dhe promovimin e pushteteve konform verdiktit të merituar zgjedhor. Deformimi i verdiktit zgjedhor nëpërmjet diferencimit mediatic të fushatave, gjithmonë do të sjellë si produkt, pushtete të pambështetura realisht dhe, për pasojë, abuzuese ndaj aspiratave të zgjedhësve.

2. Media, faktor i rëndësishëm në zgjedhje

Bashkim Tola

Votimi

Hap përfundimtar në mënyrën e shprehjes së lirë dhe demokratike të dëshirës dhe arsyetimit. Për të arritur në këtë fazë çdonjëri nga ne, strukturat partiake, komuniteti kalon në procese të ndryshme ndërgjegjësimi dhe orientimi. Por sa të drejta janë këto te fundit? A janë gjithmonë këto në sensin e duhur? Pikërisht këtu qëndron roli i medias, asaj të lirë dhe që punon për promovimin e vlerës politike, komunitare e shoqërore.

Në kushtet e mungesës së nevojave minimale për shumë grupe shoqërore dhe ndërkohë shkallës së ndryshme të nivelit arsimor ky efekt i medias bëhet edhe më i madh. Shpesh e shikojmë median në pozitat e një qëndrimi motivues dhe ndihmues për votuesit duke u shprehur drejt për anët pozitive dhe negative të çdo prezantimi politik por para se të vazhdojmë më tej i bëjmë një analizë anës ekonomike të problemit për median në vetvete. Në kushtet e rritjes dhe egzistencës me vështirësi jo rrallë ndodh që për arsye të ndryshme media të bëhet promotore për prishjen e kushteve të “fair-play”. Kjo vjen si pasojë:

- Thjesht ekonomike
- Bindjes politike
- Presionit nga faktorë politikë

1. Në kushtet e konkurrencimit, deputuesit në arenën politike nuk janë gjithmonë në kushte të barabarta potenciali mendor e

politik, avantazhit të forcës politike ose anasjelltas. Kështu blerja e medias dhe përdorimi i saj është bërë e modës dhe me efekte përcaktuese sidomos në rastet kur shkalla e njohjes të vlerave individuale të kandidatëve nga komunitetet është e ulët.

2. Jo rrallë ndodh që pronarë ose administratorë të mediave të ndryshme të jenë pjestarë të arenës politike dhe shpesh të prezantuar qartë në kahjen e tyre. Për pasojë një pjesë e madhe e tyre e quajnë normale qëndrimin e tyre në krah të këtij prezantimi edhe pse për favorin e forcës së tyre bëjnë orientimin jo të drejtë dhe shpejgimin jo të qartë të situatave.
3. Zakonisht forcat të cilat janë në pushtet e përdorin në mënyrë imponuese prezencën e tyre në taksa tatime, dogana, inspektoriate etj. Kështu presioni që mund të përdoret për mbylljen e biznesit ose uljen e nivelit të të ardhurave bën të mundur shpesh kthimin e tyre në instrumenta të rëndomtë.

Zgjedhjet politike për pushtetin qëndror kanë një nivel të lartë antagonizmi dhe kjo reflektohet në gjithshka, në mënyrën si trajtohen problemet, në përdorimin e mundësive dhe pushtetit, në rritjen e efikasitetit të të ardhurave për fushatën, në përzgjedhjen e elementëve apo shoqërive këshilluese për mënyrën e funksionimit dhe radhën e punës, në shpërdorimin e etikës deri në arrogancë e më tej përdorimin e forcës.

Në përpjekjet e tyre për të bërë sa më efikas përdorimin e medias faktorët politikë janë të prirur për të përzgjedhur elementë dhe detaje të cilat kanë ndikim më të madh dhe më të shpejtë. Në kushtet kur midis dy kandidatëve ose disa kandidatëve kemi lojë të denjë politike dhe prezantim real media e shikon veten në nivelin e arbitrit që nuk arrin të përfitojë asgjë veç të ardhurës taksative. Këtu fillon edhe përdorimi ose blerja, me qëllim rritjen ose uljen e vlerave të njërit kandidat, përdorimin e një fenomeni të rëndomtë dhe trumpetingun e tij si skandal, mosrespektimin e ligjit për kohën e përdorur në media nga forca të ndryshme, tifoza të këmbës e hapur etj.

Të gjithë e njohim faktin që shpesh herë mediat në situata të caktuara politike kanë ndikuar fort në ndryshimin e situatave. Njëqoftëse i referohemi vitit 1997, problemit të piramidave financiare, analizës që bëhej në media për to ishte e qartë ndarja

e medias në dy grupe. Nga njëra anë ajo pjesë e cila mbështeste këtë fenomen dhe e shikonte atë si zhvillim në rrugën e drejtë të ekonomisë shqiptare. Nga ana tjetër ajo pjesë e medias e cila nuk shikonte zgjidhjen, rrugën e drejtë të ecjes dhe rritjes tek ato. Kjo media bëri të mundur prezantimin hap pas hapi të fenomenit dhe në përplasjen midis këtyre dy grupeve të medias çdo njeri shikon vënien përballë të grupimeve politike duke ju bashkangjitur këtyre të fundit edhe faktorë të tjerë të brendshëm ose të jashtëm, mentalitetin e trashëguar etj.

Ka shumë rëndësi marrja në konsideratë e dallimit midis analizës dhe tendencës për t'u imponuar në vlerësimin e votuesve. Kështu nëqoftëse për një problem analizohen etapat në mënyrë të njëpasnjëshme, renditen fakte dhe argumenta të qëndrueshme, deri këtu kemi të bëjmë me një analizë. Po nëqoftëse këto fakte shtrembërohen dhe u shtohen të tjera të pavërteta, bëhen ndryshime në radhën dhe kohën e tyre, kemi të bëjmë me tendencë. Rritja e efektit të kësaj tendence bëhet e mundur nëpërmjet faktorit mediatik.

Po sjellim një shembull nëqoftëse komisioni parlamentar i ngritur për verifikimin e çështjes Rama do të funksiononte pa praninë e medias atëherë do të kishim një lloj gjykimi pa transparencë që do t'i ngjante një gjyqi me dyer të mbyllura dhe që do të zgjidhte ose jo vetëm dilemën e politikanëve të dy krahëve për problemin, ndërkohë që prania e medias e bëri këtë fenomen të ndjeshëm për të gjithë votuesit dhe bëri të mundur rritjen e mëtejshme të vlerësimit për të.

Të gjithë shprehen për ndershmëri, vendosmëri për ruajtjen e barazisë dhe lirisë të të drejtës së fjalës në media por në kushtet e fushatave jemi përballë faktit se në më të shumtën e rasteve ndodh e kundërta. Media jo vetëm që nuk i bën prezent problemet e ndryshme por nën ndikime të njëanshme i fsheh ato, i deformon problemet duke mos bërë orientimin e duhur të votuesve në gjykim të problemit. Në kushtet kur në një këshill bashkiak diskutimet e palëve për një problem të caktuar ose përgjithësisht, nuk transmetohet nga media jepet imazhi tek votuesit se në këtë këshill nuk ekziston zëri ndryshe, nuk ekziston diversiteti dhe rrahja e mendimeve. Mjafton një vend pune për të afërmit e secilit nga përfaqësuesit e medias dhe do të shikosh se media pozicionohet në të njëjtën "transhe" me

përfaqësuesit e pushtetit vendor dhe qendror. Të diskutosh dhe të ngresh probleme pa praninë e medias do të thotë “të rrahësh ujë në havan” dhe shpesh herë mund të bëhesh i bezdisur për një shumicë lajkatare të pushtetit e cila për interesa mediokre dhe jo parimore shpesh shet edhe dinjitetin. Votuesit në këto kushte nuk dinë asgjë, u zbehet mendimi se përfaqësuesit e zgjedhur, ose të paktën një pjesë e tyre mendojnë dhe shprehin aspiratat e publikut të gjerë, hallet e problemet e njerëzve, interesat urbane dhe komunitare, të momentit dhe të perspektivës. Kjo ndjenjë ata i shtyn ta shikojnë politikën si vegël të monopoleve dhe median si lëndë të parë të saj. Kësaj dileme i shtohet gjendja dhe problemet e përditshme dhe në këtë situatë shtrohet pyetja: Përse të votoj? Çfarë do të ndryshoj? Për kë të votoj? Për pasojë gjithnjë e më shumë në kushtet e një vendi në tranzicion dhe të mbarsur me probleme objektive e subjektive njerëzit që u drejtohen kutive të votimit pakësohen dhe pjesa më e madhe, ajo e cila mendohet se e kërkon ndryshimin, e do atë dhe do të jetojë të nesërmen qëndron indiferente. Shpesh rritjen e zëvendëson stanjacioni, vendin e progresit e zë rritja e gjymtuar jo në parametrat dhe kërkesat për t'u bërë bazë dhe themel i aspiratave të së ardhmes.

Fushata elektorale mbart në vetvete shumë aspekte, vlera dhe aftësi individuale të kandidatëve, reputacionin e forcave politike, lojën politike dhe gërshetimi optimal i tyre përcakton në fatin e zgjedhjeve. Nëqoftëse antagonizmit parimor dhe ballafaqimit të vlerave do t'i shtohet një media transparente rezultati do të ishte ai i pritshëm nga pjesa dërrmuese. Por jo pak herë ndodh e kundërta, kudo duke nisur nga Sh.B.A. dhe zgjedhjet atje, bllofi shoqëron dëshpërimin e humbësve për rezultatin e paparashikuar.

Megjithatë duhet të përmendim se në kushtet e një gare përdorimi më efektiv dhe me inteligjencë i medias dhe aftësisë së saj për të bindur nga njëra palë nuk do të thotë se i është bërë padrejtësi palës tjetër e cila me mefshtësinë dhe pasivitetin e saj nuk bën gjë tjetër veçse humb mbështetësit dhe reputacionin e vet. Kështu midis dy kandidatëve me diferencë në aftësitë dhe vlerat personale, mënyra se si prezantohen në publik, spotet e ndërtuara, mesazhet që ata përcjellin dhe prezantimi individual nëpërmjet medias mund të bëjë që rezultati të ndryshojë kahje. Megallomania dhe tendenca e teprimit në gjithçka kthehet në ves, dhe ky i fundit ndëshkohet me votë. Thjeshtësia dhe matura, në

shkallëzimin e ndërtimit të fazave të një fushate janë premisat e fitores.

Për gjithë më sipër media është dhe përditë përsoset në sensin e të qenit faktor determinues për përcaktimin e fatit të një konkurimi.

3. Zgjedhjet dhe media

Dr. Zhulieta Demi

Media është quajtur pushteti i katërt për nga rëndësia që ka në informimin dhe krijimin e opinioneve. Në një vend demokratik liria dhe pavarësia e medias nga pushtetet e tjerë është një domosdoshmëri, por po t'i referohemi realiteteve do të shikojmë se fjala e lirë nuk gjendet në kuptimin e mirëfilltë të saj. Me zhvillimin e madh që ka marrë media sot në vendin tonë e kudo ka krijuar lehtësira të mëdha komunikimi, informimi, argëtimi, edukimi dhe civilizimi për njerëzit. Në një shoqëri të tregut të lirë sa më e madhe të jetë një ndërmarrje mediatike aq më i madh është fitimi i pronarit të tij, sepse në shoqërinë kapitaliste qëllimi i parë i medias nuk është informimi, por përfitimi. Në tregun mediatik kemi lloje të ndryshme mediash si ajo e shkruar, radiofonike, televizive, kompjuterike, pronarët e të cilëve kanë si qëllim të parë biznesin apo politikën, por në të dy rastet ato kanë lidhje me njera tjetrën. Pronarët e mediave private kryesisht publikojnë lajme sensacionale, sportive, argëtuese, kulturore, kuriozitet, kronikat e zeza, por rrallë ato komentojnë probleme të rëndësishme siç janë shkaqet e varfërisë, papunësia, strehimi, ndotja etj, ose i prekin ato në mënyrë të përciptë për të mos t'u atakuar me politikën, sepse pushteti qendror apo lokal qoftë, merr masa nga më të ndryshmet për t'i shkatërruar biznesin në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Pronarëve mediatikë u intereson të krijojnë lidhje me politikën, për të mos çenuar fitimet e tyre. Politika e do median për të kontrolluar opinionet dhe kur ajo nuk ka mundësi ta bëjë këtë, i përpunon ato me anë të medias.

Në këtë aspekt politika ndërthuret me biznesin mediatik. Në luftën mes përfitimit dhe pavarësisë ka shumë media të fuqishme të cilat kanë krijuar identitetin e tyre në një profil të caktuar e shkruar apo elektronike p.sh., “Ora” në Kosovë “Korieri “ në Shqipëri, “New York Times”, “Washington Post” në SHBA, “Süddeutsche Zeitung” Gjermani, “Daily Telegraph”, “Observer” Britani etj.

Me gjithë rolin e madh të medias së shkruar, politika i realizon objektivat e saj elektorale më shpejt e më mirë me median elektronike, kryesisht me TV, sepse përdorimi i internetit sot në vendin tonë nuk është i fuqishëm. Është e pamundur të flasim për një fushatë elektorale moderne pa llogaritur kontributin e medias televizive.

Në fushatën elektorale TV merr një rëndësi të veçantë për partinë dhe kandidatët si individ në cilindo nivel të zgjedhjeve qendrore apo lokale. Roli kyç i medias në fillim dhe gjatë fushatës elektorale është krijimi i profilit të partisë e kandidatit si nga paraqitja e tij e jashtme dhe nga zbërthimi i programit të partisë, objektivave që shtron, nga mënyra se si ai do t'i realizojë ato. Krijimi i këtij profili ka ndikimin e tij në sensibilizimin e votuesit jo militant i cili përbën një garanci për fitoren. Politika e realizon misionin e saj në media nëpërmjet disa rubrikave të rëndësishme:

- a) Reklamave, të cilat përdoren kryesisht për të tërhequr elektoratin në votime. Në to jepen mesazhe thelbësore të programit politik të një partie të caktuar.
- b) Transmetimit direkt të ngjarjeve politike si takimet e elektoratit me udhëheqësit kryesorë të partisë etj.
- c) Intervista dhe debati: televiziv, si të tillë mund të përmendim emisionin “Opinion” në TV Klan, “Shqip” në Top Channel, “Fakt” në Nesër TV etj. Paraqitja në emisione të ndryshme krijojnë një përshtypje më të drejtë e të gjithëanëshme të problemeve që shtrohen një parti politike apo një kandidat, e cila e ndihmon publikun në përzgjedhjen e tij. Në këto emisione vlerë më të madhe merr debati, i cili ballafaqon vlerat dhe mundësitë e kandidatëve. Debati për herë të parë është përdorur nga dy kandidat për president të Shtëpisë së Bardhë, Kenedi dhe Nikson, i cili i dha një aset fitores së Kenedit. Shumë i ndjekur ishte në mediat tona debati i parë Nano – Berisha i cili ndikoi shumë në uljen e tensioneve (të asaj kohe) dhe portretizimin e të dy liderëve.

d) Lajmet: Lajmet televizive janë burimi më i rëndësishëm për informacionin politik. Gazetarët televizivë dhe ata editorialë mund të vendosin vetë se cili është lajm i rëndësishëm dhe se si duhet ta transmetojnë atë. Mënyra se si e bëjnë ata këtë varet nga profesionalizmi i tyre, nga presionet e konkurrencës, nga vetë bindjet e tyre politike. Mënyra e transmetimit të lajmit kohët e fundit, si nga media e shkruar dhe ajo elektronike, i është nënshtruar ndryshimeve të mëdha. Gazetarët përpiqen t'i përmbahen vlerave objektive të lajmit, duke qenë sa më afër të vërtetës reale. Ka shumë gazetarë që për të dhënë lajmin e vërtetë bëjnë kërkime të shumta gjersa zbulojnë gënjeshtërën apo skandalet, të fshehura nga forma e dhënies zyrtare të tij. P.sh. Gazeta "Koha Jonë", Shqiptare ... Një model i famshëm i gazetarëve investigues janë ata që zbuluan skandalin e Watergate në SHBA.

Nga ana tjetër ka shumë gazetarë që nxitojnë të bëjnë komente individuale mbi lajmin zyrtar, të cilat hedhin dyshime dhe dëmtojnë kandidatë të caktuar. Ata kërkojnë të zbulojnë të "vërtetën" dhe kapen pas detajeve të parëndësishëm, zmadhojnë lajmin gjersa e deformojnë atë. Mënyra sesi gazetari seleksionon lajmin ndikon në bërjen e opinionit. Në shtypin shqiptar ka patur raste të tilla, të cilët i kanë çuar gazetarët në bangën e të akuzuarit.

Shtrembërimi i lajmit ndodh nga dëshira për ta bërë lajmin sa më interesant për t'i rezistuar konkurrencës, por që në shumë raste krijon konflikte, kjo ndodh kryesisht me median elektronike. P.sh. Në një emision lajmesh një gazetarë e TV Klanit intervistonte kthimin e themeluesve të PD-së. Në një intervistë ajo bëri shkurtim me qëllim që të arrinte objektivin e saj, afrimin e të larguarve në PD. Në fakt i intervistuari nuk ishte larguar asnjëherë nga PD-ja, por kishte qenë me specializim për një periudhë të gjatë. Ky seleksionim i intervistës deformoi lajmin duke mos iu referuar së vërtetës.

Deformimet e lajmit kanë efekte shkatërruese tek grupimet e vogla politike, të cilat nuk e përdorin vazhdimisht median. TV mund të sigurojë ndryshime të mëdha institucionale, si në dobësimin apo fuqizimin e organizimit të një partie. P.sh. në një periudhë të caktuar thuhet se media zotërohet nga pushteti i socialistëve, të cilët deformojnë lajmet e veprimtarive të PD-së. Të njëjtat gjëra thuheshin kur PD-ja ishte në pushtet.

e) Konferencat e shtypit, të cilat kryesisht përdoren për njoftime. Ato bëjnë të mundur shkurtimin e kohës në lidhjen direkte me elektoratin. Me shumë mjeshtëri e përdori për herë të parë mikrofonin për t'u lidhur me votuesit e tij, një nga presidentët më të suksesshëm të Shtëpisë së Bardhë, Franklin Roosevelt.

Media përdoret nga politika edhe kur ajo jep emisione argëtuese, kur jep programe ekonomike apo sociale, sepse nëpërmjet njerëzve të saj ajo bën sponsorizimin e tyre, jep mesazhe që në mënyrë direkte, apo indirekte krijojnë opinione pozitive për interesat e saj. Media duke u ballafaquar me interesa kontradiktore të partive të ndryshme jo gjithmonë është një ndërmjetës korrekt i secilës parti me elektoratin e vet. Baraspeshën mediatike në një fushatë elektorale e mbajnë ligje të posaçme, por më e rëndësishme është qytetaria e gazetarëve të cilët me profesionalizmin e tyre arrijnë të kthejnë fushatën elektorale jo në një fushë beteje, por në një konkurrencë vlerash mes programeve, kandidatëve, nga përzgjedhja e të cilëve do të fitojë ai që është më i miri, ai që i është përkushtuar mendërisht, shpirtërisht ndaj ndryshimeve për një jetë më dinjitoze të qytetarëve të vet.

4. Gratë në politikë

Erisa Arizi

Në Shqipëri politika vazhdon të mbetet e dominuar nga burrat. Përfshirja e grave në politikë, megjithëse nuk ka qenë asnjëherë në nivelet e duhura, vazhdon të pësojë rënie. Ndoshta politika nuk do të ishte kaq e ashpër nëse pjesë e rëndësishme e saj do të bëheshin edhe gratë. Nuk është shumë e këndshme për tu pranuar, por sot ligjet që veprojnë mbi gruan edhe në më të mirën e mundësive janë ligje të burrave.

Shpesh herë në qendër të programeve për Shqipërinë të organizatave jo - fitimprurëse, si vendase ashtu edhe të huaja, është përfshirja e gruas në politikë. Shembulli më domethënës ishin zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2001, ku numri i femrave deputete u ul. Në zgjedhjet e vitit 1997, ishin 11 gra ligjvënëse, ndërsa në ato të vitit 2001, vetëm 9 gra u zgjodhën nga votuesit mes 140 deputetëve. Ndonëse kishin premtuar prezantimin e një numri më të madh të kandidateve gra, partitë politike bënë të kundërtën.

Politikës i mbeten ende shumë gjëra për të realizuar dhe ndryshuar. Sot, gratë janë bërë të suksesshme në biznes apo art, edhe aty ku fillimisht një grua as mendohej se mund të ishte e tillë. Asnjëherë s'ka qenë e lehtë, gjithmonë nuk përdoren standarde të njëjta si me burrat, por fakti është që ato ja dolën. Shpesh përfshirja e grave në politikë konsiderohet si një favor që i bëhet grave, a thua se ato nuk e meritojnë të merren me politikë. Ky fakt mund të jetë pasojë e traditës apo kulturës tonë (kuvendi ka qenë gjithmonë mes burrash).

Ndërsa gratë që aktualisht merren me politikën kanë vështirësi në punën e tyre të përditshme, të njëjtin mendim ndajnë edhe përfaqësues të shoqërisë civile. Shpesh gratë e sotme në politikë janë quajtur zëdhënëse të burrave.

Në tërësi lëvizja e gruas ka bërë përpjekje, por ajo nuk ka arritur të ndryshojë realitetin politik, pasi ende gruaja është larg realisht ndaj procesit të vendim-marrjes. Lëvizja vazhdon të mbetet te sloganet dhe te mënyrat propagandistike larg politikave reale për gjithëpërfshirjen e gruas në shoqërinë Shqiptare. Një shembull pozitiv na vjen nga Maqedonia dhe Kosova, ku gratë kanë arritur të ngrenë në nivel shumë të lartë përfshirjen e grave në vendim - marrje.

Gratë që sot merren me politikën e ndjejnë të nevojshme se duhet të bëjnë diçka më shumë që zëri i tyre në politikë, por edhe sfera të ndryshme të jetës, të dëgjohet më shumë. Që projektet e organizatave të ndryshme apo donatorëve të mos mbeten në letër, hapi i parë duhet hedhur nga vetë ato, për të demonstruar vlerat dhe kontributin e tyre për zhvillimin e shoqërisë shqiptare.

Gjasat janë të mira, sot shumë femra studiojnë për shkencë politike. Shumë prej tyre, sidomos gratë e moshave të reja, janë angazhuar në forume të ndryshme. Edhe përfaqësimi i grave në Akademinë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike, është një tjetër dëshmi që gjërat duhet dhe po ndryshojnë.

Le të mos vazhdojmë të paragjykojmë gratë që merren me politikë se gjoja kanë lënë pas tyre prioritete të tjera më të rëndësishme si familja dhe fëmijët (arsyetim tipik i burrave). Nëse do të mbështetemi fort në parimet demokratike të shanseve dhe të drejtave të barabarta, s'ka vend për të tilla diskutime. Bota e politikës nuk mund të vazhdojë të jetë vetëm e tyre.

Burrat dhe gratë kanë aftësi të njëjta për të gjykuar dhe vepruar. Zgjedhin të dy veprojën që të në mënyrë etike ose jo. Kanë njësoj kurajon për të vendosur synime dhe kapërcyer kufij. Zgjedhin çdo ditë ta bëjnë botën pak më të mirë apo pak më të keqe. Nëse janë pothuaj njësoj, pse nuk mund të kenë njësoj vend edhe në politikë. Thua të jetë frika e sfidës?

5. Të kuptosh politikat e zhvillimit për t'u integruar në BE

Migena Reçi

Një qeverisje e mirë është esenciale për mbështetjen e zhvillimeve. Politikat kombëtare dhe Institucionet e specializuara janë bazat për mbështetjen e zhvillimit ekonomik, për punësimin, krijimin e vendeve të punës dhe eliminimin e varfërisë.

Liria, Paqja, Siguria, respektimi i të drejtave të njeriut, rregullat - ligjet, politikat e orientimit të tregut janë një panoramë e përgjithshme për integrimin në Komunitetin Europian.

Një program i mirë për gruan, duke i dhënë asaj shanse të barabarta dhe pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrje e në institucione. Nxitja e inisiativave kombëtare për përmirësimin e legjislacionit në fushën e të drejtave gjinore, hartimin dhe zbatimin e projekteve që synojnë zvogëlimin e problemeve sociale për gratë si zbutja e varfërisë, ulja e papunësisë apo diskriminimi brenda familjes e shoqërisë.

Një politikë e mirë sociale është ajo që merret jo vetëm me zgjidhjet e sotme afat-shkurtra por ajo që dallon e shmang rrymat negative duke gjetur pasojat dhe teknikat e duhura. Injorimi i këtyre fakteve do të thotë injorim i gjithë faktorëve që lidhen me varfërinë dhe feminizimin e saj.

Duhet të kemi një program të vecant për mbështetjen e inisiativave rinore që promovojnë ide në shërbim të shoqërisë civile dhe të krijojnë alternativa për rininë. Brenda vendit për zhvillimin e demokracisë qytetare, mbrojtjen e të drejtave të rinjve në kuadrin e të drejtave të njeriut si dhe nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën publike ku prioritet në program të jenë si pika:

- Ulja e papunësisë dhe përfshirje e rinisë në trainime profesionale dhe programe punësimi;
- Integrimi i rinisë rurale në jetën shoqërore dhe kulturore të vendit;
- Promovimi i nismave për krijimin e një atmosfere integrimi dhe paqeje në vend;
- Krijimi i kapaciteteve rinore të lidërshpit rinor dhe elitës rinore.

Gjithashtu për të inkurajuar iniciativa lokale e private duke i dhënë një dinamikë të mirëfunksionimit të sektorit të biznesit, gjithashtu duhet të jetë prioritare edhe lufta ndaj korrupsionit.

Ende sot nuk është dëshmuar vullnet për zbatimin e reformave të antikorrupsionit me të cilat asistenca për luftën kundër korrupsionit ka mbetur në vend për shkak të një mjedisi tejet të korruptuar. Mendimi im antikorrupsion:

- Përqendrim më shumë te politika;
- Rritja e trysnisë mbi qeverinë e korruptuar;
- Njohja e rrjeteve të korruptuara;
- Strategji të qarta për të luftuar korrupsionin dhe zbatimi i saj.

Këto obligime janë premisa të rëndësishme për ekonominë dhe politikën e një vendi. Kjo është një përmbledhje e shkurtër e vizionit tim për një qeverisje që të çojë vendin realisht drejt një ndryshimi – për një integrim për të qenë pjesë e BE-së. Dyert për në BE janë të hapura mjafton të përgatitemi për të shkuar atje.

Ajo që do të na përgatisë është politika shqiptare me besimin që duhet të ngjallë në opinionin e brendshëm dhe opinionin ndërkombëtar se shqiptarët dinë të zhvillohen dhe të krijojnë paqe e dinë të kenë vendin që u takon në BE.

6. Procesi i Stabilizim – Asociimit

Maribel Mejd

Integrimi Euroatlantik i Shqipërisë është i lidhur në mënyrë të pazgjydhshme me të ardhmen e vendit. Tashmë dihet se anëtarësimi i Shqipërisë në BE dhe NATO është i lidhur ngushtë me prosperitetin ekonomik, me sigurinë e vendit dhe të rajonit me gjithë zhvillimin që duhet të përshkojë të gjitha fushat: sociale, politike, kulturore, arsimore etj. Me këtë synim qeveria shqiptare e ka vendosur integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe plotësimi i kriterëve për negociimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si prioritetin kryesor të programit të saj. (Marrëdhëniet diplomatike të Shqipërisë me BE-në janë vendosur në 1991. Në vitin 1992 u nënshkrua marrëveshja). Në vitin 2000 u zhvillua në Zagreb takimi i vendeve të përfshira në procesin e stabilizim-asociimit. Në këtë takim BE-ja vendosi të intensifikojë bashkëpunimin me Shqipërinë nëpërmjet krijimit të grupit të Nivelit të Lartë Drejtues Shqipëri – BE. Qëllimi i këtij grupi ishte të vlerësonte kapacitetin e Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet për një marrëveshje asociim-stabilizimi me BE-në. Ky komision vlerësoi se mbetet ende për të bërë në drejtim të plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga një marrëveshje e tillë, perspektiva e hapjes së negociatave është rruga më e mirë për të ruajtur ritmin e ndryshimeve politike dhe reformave ekonomike në vend. Pra duhet proceduar me një marrëveshje stabilizim-asociimi me Shqipërinë.

Për t'u integruar në BE, Shqipëria duhet të garantojë demokracinë, shtetin e së drejtës, respektin e të drejtave të

njeriut dhe të minoriteteve dhe nga ana tjetër të vendosë një ekonomi tregu që mund t'i bëjë ballë presionit të konkurrencës të tregut të përbashkët European. Natyrisht që ecuria e mëtejshme e procesit të integritimit pas nënshkrimit të marrëveshjes të asociim-stabilizimit do të varet nga ecuria e reformave brenda vendit dhe nga shkalla në të cilën Shqipëria do të jetë në gjendje të zbatojë angazhimet e saj që rrjedhin nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje. Hyrja e Shqipërisë në BE është një çështje kombëtare për Shqipërinë dhe shqiptarët. Zgjedhjet e ardhshme parlamentare që do të zhvillohen në verën e vitit 2005 do të jenë një tregues shumë i madh për hapat që ka bërë Shqipëria për të hyrë në BE. N.q.s zgjedhjet nuk do të jenë të standardeve që kërkohen atëherë mund të dështojë çdo iniciativë që vendi ynë të bëhet pjesë e BE-së. Shqipëria duhet të jetë e aftë t'i përgjigjet detyrimeve që rrjedhin nga “acquis communantive” – legjislacioni i Bashkimit European.

7. Roli i qytetarëve në procesin zgjedhor

Flutura Hasa

Çdokush që do ta lexojë këtë titull do të thoshte pa ta shohim njëherë, me çfarë do na e mbushi mendjen Flutura që t'ia vlejë vazhdimi i leximit. Unë do të doja t'iu tregoja këtë radhë vetëm për rolin tejet të rëndësishëm që kanë gratë në zgjedhjet tona të ardhshme.

Kam dëshirë ta filloj duke ju treguar disa fakte nga jeta jonë e përditshme, nga ambientet ku të gjithë jetojmë e punojmë.

Në ditët e sotme është e turpshme ta pohosh, por shumë e vërtetë që barrën më të madhe në familje e mbajnë gratë, që ato janë të integruara në shumicën e rasteve në punët e shtetit, apo private dhe gjithashtu përgjigjen për mbarëvajtjen e familjeve, duke u marrë me fëmijet, punët e shtëpisë dhe gjithçka tjetër.

Të tmerron ideja që shumicën e burrave shqiptarë i ke nëpër klube duke treguar bëmat e jetës së tyre dhe nuk duan t'ia dinë për gjysmën tjetër që kanë lënë në shtëpi.

Pse e thashë këtë?

Sepse ku më shumë e ku më pak situata në të gjitha zonat e Shqipërisë është kjo, ndoshta ka pak ndryshime për kryeqytetin tonë Tiranën. Atëherë këto gra që kanë në duart e tyre fatin e tyre do të vulosin po ashtu dhe fatin e zgjedhjeve tona të ardhshme, sepse në ditët e sotme të lodhura nga burrat që kanë krijuar murin e tyre të Berlinit dhe sa herë duan ato ta çajjnë aty arrijnë vetëm

të krijojnë vrima.

Po mendoni që tani që po e teproj.

Por jo...

Realiteti ynë është tepër i hidhur dhe mendoj që pika kyçe e zgjedhjeve, gratë duan një vëmendje, dhe një punë të veçantë. Sinqerisht ju them që nëse ato do të dëgjojnë dhe do të binden për ato që dëgjojnë ato jo vetëm që nuk do të përtojnë të shkojnë tek kutitë e votimit si në zgjedhjet e shkuara, por do të votojnë dhe do të jenë luftarake deri në fund.

Deri në fund jam e sigurt që shprehem gabim sepse në fund kjo luftë për të drejtat e tyre të shkelura me këmbë, ku i bie që gratë të jenë lecka e këmbëve për ta nuk ka fund.

Fund nuk mund të ketë ku me fjalë boshe dhe të mëdha politikanët tanë burra të ndritur trumpetojnë barazi dhe kur vjen puna te veprat, ua bëjnë jetën grave që duan të futen në politike si ata aq të vështirë sa t'u heqin dëshirën për të vazhduar.

*Por gratë qeshin, qajnë, dinë të punojnë të jetojnë dhe të
ënderrojnë edhe më mirë se burrat ..., por ata ua marrin
ëndrrat....*

Dhe këtë do ta ndryshojmë ne ...

Ndoshta do të jetë tmerrësisht e vështirë por jo e pamundur.

8. Standartet për minoritetet, kyç për të arritur Europën

Kostantina Bezhani

Që të vlerësosh kuotat e një niveli të caktuar, duhet t'i krahasosh ato me vlerat minimale dhe vlerat maksimale të mundshme. Po qe se do t'u referohemi kuotave të respektimit të të drejtave të minoriteteve në periudhën përpara pluralizmit, padyshim që sot kemi një nivel më të lartë.

Ndërsa, po qe se i referohemi kuotave të standardeve europiane, kuptohet që mbetet akoma rrugë për të bërë. Ashtu si edhe progresi shoqëror në tërësi edhe progresi në drejtim të respektimit të të drejtave të pakicave, nuk mund të jetë shterues, përfundimtar. Gjithmonë do të ketë vend për ndryshime dhe përmirësime.

Në Shqipëri është bërë përparim i konsiderueshëm në ndërtimin e kornizës ligjore në lidhje me minoritetet. Në një hark kohor prej rreth 10 vjetësh janë nënshkruar apo ratifikuar konventat dhe dokumentat bazë të OKB-së, OSBE-së dhe Këshillit të Europës, që iu referohen të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të pakicave në veçanti. Kemi një Kushtetutë të standarteve europiane, si dhe një numër aktesh ligjore dhe nënligjore. Por për ata që i njohin problemet deri në detaje nuk është e vështirë të konstatohet se brenda kornizës aktuale ligjore ka ende vakum. Për shembull, kur hapet debati për emërtimin e rrugëve apo të shenjave topografike edhe në gjuhën e minoritetit në ato qendra të banuara, ku pjesëtarët e pakicës përbëjnë shumicën në strukturën e popullsisë, legjislacioni aktual nuk është në gjendje të ofrojë një zgjidhje. E njëjta gjë ndodh edhe kur bëhet fjalë për përdorimin

e gjuhës amtare të pakicave në marrëdhëniet me autoritetet administrative lokale, etj. Ashtu siç ka edhe shumë raste kur ligji vetëm botohet në Fletoren Zyrtare dhe askush nuk kujtohet apo angazhohet për zbatimin e tij. Ose më keq, kur ligji dhunohet dhe shkelet në dëm të interesave të ligjshme të pakicave.

Komiteti Shtetëror i Minoriteteve ka bërë propozime të vlefshme për plotësimin e disa boshllëqeve ligjore, si dhe për disa përmirësime në kornizën aktuale, si dhe ka protestuar me forcë dhe ka kërkuar zgjidhje ligjore për të gjitha rastet e dhunimit të të drejtave të minoriteteve.

Nga përvoja e shumë vendeve në Ballkan apo jashtë tij kemi mësuar se atje ku problemet e minoriteteve nuk janë zgjidhur në kohën dhe mënyrën e duhur, aty kanë lindur vatra tensionesh dhe paqëndrueshmërie. Prandaj nëse seriozisht duam të përfshihemi në Evropë, duhet që po kaq seriozisht të vlerësojmë çdo aspekt që ka të bëjë me plotësimin e standardeve ndaj minoriteteve. Nuk mund të ketë integrim me vendet jashtë hapësirës së Shqipërisë, nëse nuk ka një integrim real dhe të prekshëm brenda kësaj hapësire. Dhe në këtë integrim të brendshëm, kuptohet që vendin kryesor e zë integrimi dhe përfshirja e minoriteteve në të gjitha përmasat dhe parametrat e duhur.

Komiteti Shtetëror i Minoriteteve ka ndërhyrë dhe ka vënë në rrugën e zgjidhjes shumë probleme që lidhen me minoritetin grek, si vendosja e tabelave dygjuhëshe në emërtimet e rrugëve dhe vendbanimet, hapja apo funksionimi i njësive të ndryshme të shkollimit dhe mësimin të gjuhës amtare, përfshirja më e madhe e minoritarëve në administratën publike.

Nuk ka rëndësi fakti nëse një pakicë është në numër më të madh apo të vogël nga pakica tjetër. Standartet janë një dhe iu referohen çdo individ që i përket pakicave. Në përgjithësi ato probleme që ndeshen në minoritetin grek i gjen edhe në minoritetin maqedonas apo serbo - malazez. Por megjithatë, për fat të keq vihet re se sa më i vogël të jetë numri i minoritarëve në një krahinë apo në një qendër të banuar, kaq më i vogël është dhe kujdesi dhe interesimi për to. Tipik është rasti i minoritetit sebo-malazez, ku edhe disavantazhi numerik ka bërë që për këtë pjesë të pakicave të mos ketë akoma as edhe një njësi për shkollimin apo mësimin e gjuhës amtare. Por sipas ligjit shqiptar, duhet bërë një kërkesë nga prindërit e fëmijëve me kombësi jo-shqiptare një

vit më parë për hapjen e një shkolle, gjë e cila deri tani nuk është bërë. Kështu nëse ka një përqendrim vëmendjeje dhe investimi shoqëror për minoritarët grekë që jetojnë në Dropull, Pogon, Delvinë apo Sarandë, në qendrat e banuara jashtë kësaj hapësire kjo vëmendje dhe ky investim shfaqet në progresion zbritës.

Është një arritje për t'u shënuar fakti që vitet e fundit shteti shqiptar ka njohur për herë të parë ligjërisht ekzistencën edhe të dy minoriteteve gjuhësore: atij vllah (arumun) dhe rom. Por procesi nuk mbaron me njohjen legale të tyre, përkundrazi ai fillon me këtë njohje. Shoqëria shqiptare duhet ta ndjejë si një detyrim historik kontributin për ruajtjen, arkivimin dhe njohjen e gjuhës dhe kulturës së tyre. Gjithashtu duhet shumë punë për të ingranuar me dinjtet në jetën ekonomike, shoqërore dhe politike të vendit edhe komunitetin rom të Shqipërisë. Qeveria ka miratuar një strategji për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve. Dikastere të ndryshme kanë hartuar programe të tjera punësimi dhe përfshirjeje. Por veprimi konkret akoma është i vakët dhe ai mezi arrin në strehëzat e varfëra të romëve. Ndërkohë që vazhdojnë rastet e dikriminimit dhe marxhinalizimit social të këtij komuniteti për të cilat KSHM ka mbajtur qëndrim dhe ka manifestuar angazhim maksimal.

Krijimi i Komitetit Shtetëror të Minoriteteve shënon në vetvete një zhvillim pozitiv në drejtim të integritit të pakicave në administratën publike. Është hera e parë që në një institucion që merret me minoritetet punësohen përfaqësues të minoriteteve. Edhe pse me një status sugjerues - rekomandues, KSHM ka dhënë kontributin e tij për shumë çështje që lidhen me minoritetet. Por efektiviteti i punës së këtij institucioni do të ishte më i ndjeshëm, nëse statusi institucional i tij do të ishte në nivel më të lartë. Edhe përvoja e shumë vendeve të Europës e përforcon këtë ide.

9. Dhënia e informacionit gjatë zgjedhjeve

Ziza Isufi

Informacioni publik është mjete i vetëm më i fuqishëm i veprimit publik. Në një shoqëri moderne demokratike, mënyra më efektive për të shpërndarë informacionin publik është përmes medias së shkruar dhe asaj audiovizive. Me anë të medias, kandidatët në zgjedhje mund të prezantojnë alternativat e tyre e të mbërthejnë imagjinatën e njerëzve dhe mbase të shtojnë rradhët e përpjekjes së tyre me njerëz të rinj.

Komunikimi në media mund të jetë i fituar ose i paguar. Media e fituar i referohet intervistave, historive dhe ngjarjeve që i përkasin partisë ose kandidatëve të partisë, të cilët raportohen nga media për arsye të vlerës që kanë. Media e fituar është një mënyrë për t'u komunikuar një mesazh votuesve pa e bërë pagesën. Media e paguar kërkon nga partia të përdorë burimet e saj për të blerë hapësirë në televizion, në radio, apo për reklamimin e tyre në shtyp.

Kur kryetari i partisë, kandidati apo ndonjë zëdhënës tjetër flet me reporterët, ai duhet të gjejë një ekuilibër mes informacionit faktual dhe atij provokativ. Zëdhënësi duhet ta paraqesë partinë e tij dhe kandidatin në mënyrën më të favorshme që është e mundur. Drejtuesit e komunikacionit duhet të përpiqen që të krijojnë lidhje si me median e fituar, ashtu edhe me median e paguar.

Ngritja e mardhënieve efektive me median mund të nxjerrë më në pah veprimtarinë e kandidatëve dhe mund të rrisë numrin e reportazheve, kronikave, debateve të ndryshme televizive për ngjarjet që ata organizojnë.

Në mënyrë që të ketë një program efektiv, drejtuesi i komunikimit të partisë apo i kandidatit mund të përpilojë një listë me emrat dhe adresat e gazetave të përditshme dhe javore, të reporterëve publikë, radiove, revistave dhe korrespondentëve televizivë. Është e rëndësishme të ketë informacion mbi afatet, programet e transmetimit, orarin e punës, në mënyrë që të dëgjojë një numër sa më i madh njerëzish.

Kush, çfarë, kur, ku dhe pse janë pyetje të cilat duhet të kenë përgjigje në një artikull. Lajmi nuk duhet të kalojë hapësirën prej një faqeje. Titulli është i rëndësishëm për suksesin e lajmit. Ai duhet të përmbledhë lajmin dhe fjalia e parë duhet të jetë e fortë dhe informative. Informacioni më i rëndësishëm duhet vënë në fillim. Do të ishte interesante të përdorej një citim, sentencë apo aforizma të një politikani me emër.

Njoftimet për median u dërgohen anëtarëve të medias para një fushatë elektorale, debati apo ngjarjeje, për t'i njoftuar ata mbi vendin, kohën, datën, si dhe mbi ndonjë detaj tjetër. Njoftimet i ndihmojnë editorët të planifikojnë që përpara dhe të njoftojnë reporterët për të përgatitur programin.

Një konferencë shtypi duhet të programohet vetëm kur ka lajme të tilla që e kërkojnë atë. Konferenca bën që shtypi ta dëgjojë lajmin së pari, pastaj të bëjë pyetje për raportim më të hollësishëm. Ato konferenca që nuk kanë lajme të rëndësishme nuk do të kenë shumë pjesëmarrës ose lajm në gazetatat e së nesërme. Reporterët do bëhen skeptikë dhe nuk do të vijnë as në konferencat e tjera që mund të kenë lajme shumë të rëndësishme.

Lajmet që kërkojnë një konferencë shtypi janë si ngjarje që influencojnë zonën, pozicionet e partisë mbi çështje të ndryshme, sfida ndaj një qëndrimi të kundërshtarit.

Gjatë organizimit të konferencës duhet që kandidati të jetë i përgatitur sepse reporterët mund të bëjnë pyetje që janë të vështira dhe kaq duhet që ai të merret nëpër gojë.

Duhet ditur që reporterët kanë afatet e tyre për të dokumentuar intervistat e tyre, kështu që duhet kombinuar me to. Media do të bëjë çdo lloj pyetje, prandaj kryetari i partisë, kandidati apo zëdhënësi duhet të jenë të përgatitur.

Para konferencës shpërndahet lajmi i përmbledhur i saj. Ajo duhet të zgjasë 20-30 minuta duke përfshirë edhe pyetje-përgjigjet.

Duhet mundësuar inçizimi i konferencës për t'i dhënë materialin atyre reporterëve që nuk kanë mundur të vijnë aty.

Duhet bërë kujdes në përgatitjen e fletës së shtypit dhe të medias. Fleta e shtypit dhe e medias është një libër i vogël informacioni që shpërndahet në konferenca shtypi ose postohet si një metodë komunikimi me shtypin. Ajo duhet të përmbajë biografinë e kandidatit, fotografinë, informacion familjar, një kopje të lajmit të shtypit, informacion mbi fushatën elektorale dhe kopje të fjalimeve të fundit.

Krahas konferencave për shtyp, forumi, bisedat ose debati mund të jenë një moment decisiv në fushatën politike sepse kandidati ka rast të bëjë kontrast me kundërshtarin. Momenti kritik në shumicën e debateve është kur një kandidat bën ndonjë gabim.

Debatet mund të kenë forma të ndryshme. Pyetjet mund t'i bëjë një person i vetëm, një grup njerëzish, audienca ose vetë debatuesit që i bëjnë pyetje njeri-tjetrit. Shumica e debateve i lë një vend çdo kandidati të bëjë një hyrje. Hyrja është e rëndësishme sepse i jep tonin gjithë debatit.

Për të bërë një debat të frutshëm duhet që kandidati të jetë ofensiv pa qenë agresiv, të theksojë pozitiven, të jetë konçiz në përgjigjet e pyetjeve dhe sulmet, të theksojë pozicionet e tij qartë në dy e më shumë fjali dhe të shpjegohet sipas kohës që ka në dispozicion. Gjithashtu kandidati duhet të mbajë parasysht që gjatë debatit të jetë i respektueshëm, të drejtojë diskutimin në avantazhin e tij, të theksojë mesazhin dhe të diskutojë temat e fushatës së tij, mos t'u shmanget pyetjeve direkte, të merret me shqetësimet e elektoratit të tij, të mos diskutojë për çështje që nuk njihen.

Komunikimi nëpërmjet medias paraqet një mënyrë tjetër për të transmetuar informacionin mbi veprimtarinë e partisë apo kandidatit tek një masë e madhe njerëzish në të njejtën kohë. Njohja e ambientit mediatik të zonës përmirëson aftësitë e shfrytëzimit sa më të mirë të pushtetit të katërt. Por me median e shkruar dhe audivizive duhet bërë kujdes.

Është patetike kur vëren në ekran politikanë tek thonë fjalë naive, tek hidhen si arinjte sëbashku me drejtuesen e programit, apo kur i nënshtrohen bezdive të çdo tipi, vetëm e vetëm për të figuruar në plan të parë. Duke ndjekur këta shembuj, shumë

njerëz me qëllime të mira, nuk kuptojnë se si ndodh që mesazhet e tyre deformohen apo zëvendësohen kur arrijnë te publiku i gjerë nëpërmjet disa mjeteve të komunikimit. Kjo, nxjerr aspekte të Mbretërisë së Medias që veprojnë duke i zhvilluar temat e rëndësishme e duke sjellë si pasojë dezinformimin e publikut, që pretendohet se sqarohet me këtë. Çuditërisht shumë njerëz progresistë bien në këtë kurth pa kuptuar shumë mirë se si publiciteti i dukshëm që u është bërë, jep një efekt të kundërt.

Nganjëherë, ia vlen barra qeranë të paralajmërohen të pavëmendshmit që duke u munduar të komunikojnë idetë e tyre, nuk e pikasin territorin e çuditshëm ku janë mbyllur.

10. Pse kaq e vështirë?!

Suela Kokoshi

Përse është kaq e vështirë të bësh zgjedhje normale në Shqipëri?! (ose siç përdoret rëndom sot në tryeza politike apo media “zgjedhje të lira dhe të ndershme”).

Kjo pyetje ka 14 vjet që rri varur në vetëdijen qytetare dhe kërkon një analizë të thellë dhe shumëdimensionale për vetë rëndësinë jetike që paraqet proçesi i zgjedhjeve për këtë vend.

Si ka mundësi që një vend kaq i vogël, me 1.000.000 votues (jashtë proçesit emigrantët), me një popullsi dhe territor të papërfillshëm krahasuar me vendet e tjera demokratike perëndimore, i etur për liri dhe drejtësi, për të cilat ka sakrifikuar si askush tjetër mijëra jetë njerëzore në qindra vjet, toleron formësimin e një pushteti ireal, produkt i zgjedhjeve të manipuluar?

Sipas mendimit tim, elektorati shqiptar, i zhveshur nga çdo mundësi tjetër, ka filluar në zgjedhjet e fundit 2001, 2003 bojkotimin masiv të tyre.

Ai ka kuptuar se manipulimi masiv i zgjedhjeve në Shqipëri ndodh sepse klasa politike shqiptare e koncepton marrjen me politikë në funksion të interesave të saj private dhe jo në shërbim të popullit siç ndodh kudo në perëndim.

Kjo tashmë ka prodhuar një sërë faktorësh ekstremisht negativë si: destabilitet politik, bllokim të reformave ekonomike, krijim monopolesh të rrezikshme, informalitet në ekonomi, varfëri ekstreme dhe sot ne jemi në kufijtë e dominimit të politikës nga krimi i organizuar dhe korrupsioni.

Të gjitha këto në sytë analistë të publikut, kompromentojnë

rëndë sistemin e lirisë dhe të nismës së lirë.

Thënë më qartë kompromentojnë sistemin e demokracisë pluraliste për të cilën ëndërruan aq shumë, breza të tërë shqiptarësh. Sot ka arritur pika e vlimit dhe shumë njerëz pyesin: “Mos ishim më mirë përpara viteve '90 ?!”

Është absurde të bësh një aluzion të tillë, sepse ky që po përjeton sot shoqëria shqiptare nuk është sistemi i vërtetë kapitalist i vlerave të lirisë dhe dinjitetit njerëzor, por një e keqe e skajshme e skicuar me ndërgjegje të plotë nga një klasë politike e paaftë dhe e papërgjegjshme, e cila përpara interesave meskine private nuk shikon asgjë tjetër, dhe sot nuk mund t'i japë përgjigje mijëra pensionistëve dhe të papunëve që në vendin me pozicionin më të mirë gjeografik në glob, jetojnë paradoksalisht nën nivelin jetik të varfërisë, në skamje dhe mjerim absurd.

Duke kuptuar këtë situatë, e cila rrezikon të dalë jashtë çdo kontrolli, perëndimi ka drejtuar gjithë vëmendjen tek zgjedhjet e vitit 2005, si pika ndarëse përfundimtare e cila ose e fut Shqipërinë në shinat normale të zhvillimit, ose e nxjerr përfundimisht jashtë sistemit në një udhë pa krye dhe që askush nuk e di se ku të shpie.

Unë besoj se organizmat ndërkombëtarë të cilët kanë harxhuar dhe investuar miliarda dollarë dhe mijëra orë energji njerëzore, duke e parë Shqipërinë si pjesë të sistemit dhe të rajonit të Ballkanit perëndimor, nuk do të lejojnë që të ndodhë kjo e dyta, sepse ata vetë mbajnë një pjesë të përgjegjësisë, me raportet evasive të organizmave të tyre pas çdo raundi zgjedhor, raporte të cilat në një farë mënyre kanë inkurajuar manipulatorët për të bërë manipulim pas manipulimi për të ardhur deri këtu ku jemi sot.

Mendoj se në korrik 2005 do të thuhet STOP dhe ky stop do të mbyllë përfundimisht këtë periudhë tjetër të errët të historisë tonë politike e cila quhet T R A N Z I C I O N.

Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA)

Instituti Demokratik Amerikan për Çështje Ndërkombëtare (National Democratic Institute for International Affairs), Partnerët për Ndryshim Demokratik (Partnerët Shqipëri), dhe Bordi Ndërkombëtar për Kërkime dhe Shkëmbime (IREX), janë Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA). Sfida përpara Shqipërisë është të adresojë korrupsionin dhe të krijojë një kulturë politike të hapur, pjesëmarrëse dhe transparente. Për ta përmbushur këtë, qytetarët duhet të organizohen për të devijuar fokusin e qeveritarëve nga përfitimet vetjake drejt një shërbimi më të mirë ndaj interesit publik. Konsorciumi DGA, i bazuar në eksperiencën e tij në Shqipëri dhe e gatshme me ide të reja, punon me kolegë shqiptarë dhe ndërkombëtarë për arritjen e këtij qëllimi.

Me mbështetjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Konsorciumi DGA ndihmon grupet civile t'i hapin dyert qeverive lokale nëpërmjet organizimit avokacisë dhe përpejkjeve vëzhguese, bordeve organizuese qytetare dhe takimeve publike. OJF-të në nivel kombëtar grupohen bashkë dhe krijojnë mekanizma të fortë për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin legjislativ. Gazetarët rrisin standardet e tyre profesionale dhe u japin qytetarëve informacionin që ata duan për të ndarë opinionet dhe u japin zë ideve të tyre. Partitë politike janë më përgjegjëse ndaj publikut, shtrirjes së qytetarëve, demokratizimit të veprimtarive të brendshme dhe nxit breza të rinj udhëheqës. Zgjedhjet shqiptare do të bëhen më demokratike kur me qindra

qytetarë të marrin pjesë në aktivitetet e planifikuara për të monitoruar procesin zgjedhor. Në të gjithë këto aktivitete, gratë janë pjesëmarrëse të dalluara, kështu që ato mund të luajnë një rol në rritje, të dukshëm dhe të rëndësishëm në jetën publike.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Politikani i Ri : fletore e Akademisë për udhëheqësi
dhe reformë politike/ përg. National Democratic Institute
for International Affairs / Dan Redford, etj. - -

Tiranë : Pegi, 2005 .

V.3, 31 f. ; 20.7

ISBN 99943-705-5-3

324(496.5) :659.3

659.3(496.5) :324

324.8(496.5)